



PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Nr. 22

Datë: 04. 05. 2020. Ora: 12:00

Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë.

Kryesuese e mbledhjes: Valdete Daka, kryetare

Në mbledhje morën pjesë anëtarët e KQZ: Sami Hamiti, Sami Kurteshi, Alim Rama, Arianit Elshani, Ibrahim Selmanaj, Eshref Vishi, Nenad Rikalo, Rifat Krasniq, Čemailj Kurtiši, Artan Asllani.

SKQZ: Yll Buleshkaj, u.d. i Kryeshefit

Përkthyes: Argjina Misini

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi.

RENDI I DITËS

1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së;

2. Raporti i Këshillave të KQZ-së:

- **Këshilli për Buxhet dhe Financa:**

- Shqyrtimi dhe miratimi i raportit tre mujor financiar të KQZ-së për periudhën janar-mars 2020.
- Shqyrtimi dhe miratimi i raportit të shpenzimeve për zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Kosovës 2019.

3. Të ndryshme.

(p.s. Kjo mbledhje, për arsye të pandemisë Kovid – 19, realizohet në mënyrë teknologjike, përmes sistemit “Skype” – Internet)

1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së

Valdete Daka: Përshëndetje të gjithëve, e hapi mbledhjen e 22- të me rendin e ditës sic e keni marrë, dhe ju pyes kush është për këtë rend dite...?

Falemnderit, aprovohet. Vazhdojmë me pikën e parë...

Raporti i Këshillave të KQZ-së:

Këshilli për Buxhet dhe Financa:

Shqyrtimi dhe miratimi i raportit tre mujor financiar të KQZ-së për periudhën janar-mars 2020.

Sami Hamiti: Falemnderit. Përshëndetje të gjithëve ! Sot e kemi mbajtur mbledhjen e tetë: Kemi shqyrtuar raportit tre mujor financiar të KQZ-së për periudhën janar-mars 2020, dhe raportin e shpenzimeve për zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Kosovës 2019. Në raportin tremujorë, kishim një konkluzion të përbashkët dhe, është një raport i strukturuar, mirë, i shkruar mirë në bazë të kërkesave që ka ligji për menaxhimin e financave publike, dhe kërkesave që ka MeF. Nëse e analizoni, dy shpenzimet vijuese të rregullta, pagat dhe mëditjet dhe subvencionet për subjektet politike, janë brenda trendit shpenzues. Kurse për shpenzimet për mallra dhe shpenzime, kishim një vërejtje sepse, prej 89 mijë euro, rreth 50 mijë euro janë mjete që janë marrë me një vendim të gjykatës. Pjesa tjetër, rreth 37 mijë euro, janë mjete për shpenzime të rregullta, kurse 51 mijë euro, janë marrë nga gjykata dhe ministria i ka ekzekutuar. Shpenzimi, ka ndodh në vitin 2017, dhe ka qenë në shumën 41 mijë euro. Shpenzimet tjera, 10 mijë euro: kamata dhe shpenzime për përmbaruesin, janë vërejtjet që këto shpenzime ma mos të përsëriten.

Me këtë vërejtje, e kemi votuar dhe si raport, të aprovohet...

Valdte Daka: E hapi diskutimin...?

Eshref Vishi: Gati në tërësi pajtohem me fjalën e kryesuesit të këshillit, për raportimin lidhur me shpenzimet për tre tremujorin e fundit. Në këtë raport tremujorë, shihet se kemi një kuotë të ulët të shpenzimeve, e gjithë kjo për shkak të situatës së krijuar, e ku shpenzimet nuk lëvizin në bazë të planifikimit. Vetëm buxheti për paga dhe menditje dhe subvencione e transferove, është realizuar në bazë të planifikimit. Unë, do të ndalesha te neni 17, e që përmbledh detyrimet e

papaguara. Fjala është për një shumë jo shumë të lartë, mirëpo kjo ka të bëjë me kategorinë e mallrave dhe shërbimeve, dhe me trupat zgjedhor të KVV-e të cilët ende nuk janë paguar! Administrata e arsyeton këtë me të dhënat që janë dërguar gabim nga KVV, mirëpo këto duhet të paguhen dhe të shlyhen. Komunikimi duhet të nisë më shpejt me anëtarët e KVV, dhe detyrimet të paguhen. Detyrimet tek neni 18, detyrimet kontingjente që i përmendi z. Samiu, kanë të bëjnë me tejkalimet e kontratave gjë që duhet të fokusohemi më shumë tek përgjegjësitë dhe se, administrata duhet të mbajë përgjegjësi, dhe sipas mendimit tim kjo është pasojë e mos planifikimit të saktë dhe mos zhvillimit të drejtë të procedurave të prokurimit nga administrata. Kjo, ka sjellë si pasojë kompensimet për kamatat për operatorët dhe shpenzimet gjyqësore. Lëshimet e tilla duhet të adresohen, dhe të ngritët niveli i përgjegjësisë së zyrtarëve ! Nuk duhet të përfundoj gjithçka me një ngritje dore që të votohet raporti. Kjo, nuk duhet të përsëritet ma...

Valdete Daka: Ju siç e dini, unë kam kërkuar edhe një auditim të brendshëm nga auditori, i cili e ka përgatitë tashmë draftin. Sapo të përfundoj situata e Kovid - 19, do të merremi edhe me këto çështje. I kemi ngritur edhe më herët problemet në takimet tona në mësimet e nxëna, dhe i kemi evidentuar shkeljet...! Besoj që, në të ardhmen do të shohim se çka ka ndodhur me këto tejkalime.

Sami Hamiti: Po, është evidente: te detyrimet kontingjente këtë që po e shihni – 177 – mijëshi për vitin 2020, është i bartur nga viti 2017. Saktë: 244 mijë euro ka qenë aso kohe tejkalimi në kontratë. E dini që KQZ, auditorit i është ndarë edhe një detyrë: të auditoj këtë pozicion, këtë operator. Ne, aso kohe jemi njoftuar mbasi ka ndodhë, madje mbasi janë certifikuar rezultatet. Në KQZ, muaj më vonë e kemi marrë vesh që ka tejkalim. Ma, nuk ka por kjo shumë që po shihet, operatorët do ti marrin kamatat ndëshkuese sepse, është me ligj...! Sekretariati, për me mbulue vetën, ka bërë prapësime dhe për këtë, janë rritë kamatat...

Sami Kurteshi: Ju dëgjova në lidhje me raportin, por unë kam një propozim! Është çështja e hartimit të këtyre raporteve të karakterit financiarë. Ngase KQZ, e ka auditorin e brendshëm si institucionet e tjera, unë mendoj se kishte me qenë mirë që, pas hartimit të raporteve, ti lihet një pjesë – hapësirë raportit që auditori, të bëjnë një analizë dhe që ai, të na vijë me analizat e tij. Edhe për ne që mund të jemi më laik në çështjet financiare, ta kemi një pasqyrë të dyanshëm: një nga Sekretariati, dhe një nga auditori me vlerësimet e tij...

Sami Hamiti: Kërkesa është e rëndësishme, por ne se kemi formuar Këshillin e Audimit, dhe ne fatkeqësisht nuk e kemi sipas ligjit, edhe me dy auditorë të jashtëm... Mendoj që, duhet të përkushtohemi ta formulojmë këtë komitet – këshillë, dhe se kërkesa e Samiut është shumë legjitime...

Valdete Daka: A ka dikush tjetër...? Nëse jo, e hedh në votim. Kush është për...? Falemnderit.

Anëtarët e KQZ, me 10 vota për, e miratuan këtë rekomandim të Këshillit për Buxhet.

Shqyrtimi dhe miratimi i raportit të shpenzimeve për zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Kosovës 2019.

Sami Hamiti: Pikë tjetër është raporti i shpenzimeve për zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Kosovës 2019. E kemi shqyrtuar në takimin tonë, dhe i kemi sugjeruar KQZ që si të këtillë, ta votojë. Konsideroj që është raport i hartuar mirë, dhe përmban të gjitha elementit e një raporti nga shpenzimet zgjedhore. I keni të specifikuar dhe të analizuar shpenzimet, dhe është tabela përmbledhëse në fq. 24.

Në vazhdim, kryesuesi i KB-së z. Hamiti, bëri një analizë zbërthyesë të raportit. Ai, tha se, raporti është votuar unanimisht në takim nga anëtarët e këshillit...

Valdete Daka: Pra siç e shihni, zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kuvend të 6 tetorit 2019, kanë kushtuar 5. 176. 295 euro. Pjesa më e madhe e shpenzimeve ka shkuar te stafi jo permanent, dhe te KVV-të e KKZ-të. Në zgjedhjet e ardhshme, do të kemi analizë në mënyrë që këto shpenzime, të reduktohen.

Alim Rama: Edhe në këtë rast, duhet me ardh një raport i auditorit që neve na tregon se këto shpenzime janë bërë si duhet. Po ashtu, raporti po tregon se krahasuar me zgjedhjet e 2017 (kemi pasur pak më shumë se 4 milion), kemi rritje të shpenzimeve për 25%, në zgjedhjet 2019. Këto shpenzime, duhet mu arsyet !

Valdete Daka: Po, pagesat për trupat zgjedhore janë rritë për 30% në zgjedhjet 2019. Dhe, kemi pasur shtesë të 57 vendvotimeve të reja. Kështu që, këto zgjedhje dalin më të shtrenjta...Sigurisht, duhet ta shohim angazhimin e stafit jo permanent...

Sami Kurteshi: (nuk kuptohet pyetja për shkaqe teknike...) Por, pyetja ka të bëjë – në bazë të përgjigjeve, rreth rinumërimit të votave...

Valdete Daka: Ka qenë një vendim i PZAP-së rreth rinumërimit dhe ne nuk mundemi me ndikuar, por shpenzimet e rinumërimit në QNR, nuk e kalojnë shumën e mbi 170 mijë eurove...

Sami Kurteshi: Nuk e kisha ndonjë dyshim, por më interesonte vetëm si shtesë sa ka qenë...Faleminderit...

Në vazhdim, diskutimet u fokusuan rreth qasjes, vlerësimit dhe analizës së auditimit të brendshëm, si për zgjedhjet e parakohshme të 6 tetorit, po ashtu edhe për stafin e brendshëm. Në diskutim, morën pjesë: Sami Hamiti, Valdete Daka, Sami Kurteshi.

Valdete Daka: Kush është për këtë raport...?

Anëtarët e KQZ, me 10 vota për, e miratuan këtë rekomandim të Këshillit për Buxhet.

Të ndryshme !

Arianit Elshani: Në mbledhjen e kaluar, u përmend shkarazi një raport që po tentohet të krijohet prej një pale të tretë ! Kjo, është përmendur lidhur me organo gramin dhe strukturën e Sekretariatit. Nuk kam informacion, por çfarëdo ndryshimi eventual, duhet të iniciohet nga KQZ. Si KQZ, nuk e di nëse kemi votuar diçka të këtillë ! Më pengon kjo, dhe nuk e di nëse ju jeni të njoftuar...?

(p.s. Teknikisht, nuk kuptohen diskutimet e mëtejshme lidhur me çështjen e shtruar nga z. Elshani...)